



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 116 Prot.

Tiranë më 19. 04. 2021

URDHËR

Nr. 43 datë 19. 04. 2021

**“Për Njoftimin e Shpalljes së Thirrjes Nr. 14 për Projekt- Propozime
për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”**

Në bazë të Ligjit Nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 769 datë 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” (I Ndryshuar) dhe në zbatim të Vendimit Nr. 109/ 1 të Bordit Mbikqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile të datës 16. 04. 2021:

URDHËROJ

1. Njoftimin për shpalljen e Thirrjes Nr. 14 për Projekt- Propozime;
2. Njoftimi të realizohet në faqen zyrtare të AMSHC- së, në internet si dhe në katër gazeta në vend;
3. Shpallja ka efekt nga data 19. 04. 2021 deri më 20. 05. 2021 ora 16: 30;
4. Shpallja në shtypin e shkruar do të bëhet në datat 23. 04. 2021 dhe 11. 05. 2021;
5. Ngarkohet Sekretaria për protokollimin dhe njoftimin e këtij Urdhri;
6. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet:
 - a. Sektori i Financës dhe i Kontrollit të Brendshëm;

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konc. F. AGA

DREJTORI EKZEKUTIV

